



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:156749
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837424

Ac.nr.4656/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Halide Reka anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditësve V. Th dhe E. H të dy nga Komuna e Rahovecit, të punësuar në SHML “...” në ..., Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati S. M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor avokat Bilbil Oruçi, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.699/2021 të datës 28.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.699/2021 i datës 28.03.2022, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësve V. Th dhe E. H, si dhe detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që: Paditësit të parë V. Th Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri 18.04.2021, për 27 % të pagës mujore (522,34 €), 27 % =77,35 € x 48 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,712.80 €, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me datën 31.12.2021, për 10 %, të pagës mujore = 52,23 € x 8 muaj, t'i paguaj shumën prej 401,84 €. Paditësit të dytë E. H nga Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri 18.04.2021, për 27 % të pagës mujore (530,16 €), 27 % =79,46 € x 48 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,814.08 €, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me datën 31.12.2021, për 10

%, të pagës mujore = 53,01 € x 8 muaj, t'i paguaj shumën prej 424,08 €, apo në shumë të përgjithshme prej 8,352.80 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (13.07.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, si me bazë. Detyrohet e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 535,80 € me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prishet aktgjykimi dhe të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia si e pa bazuar apo të prishet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit V. Th dhe E. H kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj: paditësit të parë V. Th nga Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri 18.04.2021, për 27 % të pagës mujore (522,34 €), 27 % = 77,35 € x 48 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,712.80 €, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me datën 31.12.2021, për 10 %, të pagës mujore = 52,23 € x 8 muaj, t'i paguaj shumën prej 401,84 €. Paditësit të dytë E. H nga Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri 18.04.2021, për 27 % të pagës mujore (530,16 €), 27 % = 79,46 € x 48 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,814.08 €, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me datën 31.12.2021, për 10 %, të pagës mujore = 53,01 € x 8 muaj, t'i paguaj shumën prej 424,08 €, apo në shumë të përgjithshme prej 8,352.80 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësi V. Th ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës i biologjisë në SHML "... " në ... Paditësi E. H ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës i gjuhës angleze në SHML "... "

në ... Paditësi i parë V. Th është diplomuar në Degën e Biologjisë. Paditësi i dytë E. H është diplomuar në Degën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe. Paditësit janë pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt. Paditësi V. Th është kompensuar në shumë prej 63.68 €. Paditësi E. H ka pagën bruto në shumë prej 597,22 €.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Lidhur me ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i përfshirë as me shkeljet e pretenduara e as me shkelje esenciale neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, kolegji i Gjykatës së Apelit gjenë se, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi V. Th është diplomuar në Degën e Biologjisë dhe se është i pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, ndërsa paditësi E. H është diplomuar në Degën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe është pajisur me licencë të karrierës, nivel i rregullt. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka gjetur se e paditura nuk i ka bërë pagesat paditësve lidhur me licencimin.

Lidhur me aplikimin e të drejtës materiale, Gjykata e Apelit gjen se e drejta e paditësve për pagesat lidhur me licencimin buron nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023. Ndonëse paditësit në parashtrimet e tyre, janë thirrur në Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar është përcaktuar se: *“Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë : Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës Bazë”,* kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se në nenin 2.2 të LPK-së, është parashikuar që: *“Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.* Sipas nenit 2.2 kualifikimin juridik të kërkesës e bën gjykata, sepse vlen parimi fundamental *da mihi facta, dabo tibi ius [më jep faktin të jap të drejtën]*.

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë apo baza për kompensim për tu trajtuar kërkesat e tilla gjendet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 dhe

çështja e kompensimit të mësim dhënësve mbi bazën e kualifikimit (licencimit) duhet të trajtohet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e qeverisë, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me 06.02.2023¹, kolegji gjen se meqë nuk krijohet ndonjë gjendje tjetër juridike, për të vendosur ndryshe nga sa është vendosur në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kolegji i Gjykatës së Apelit ka vendosur që pretendimet ankimore edhe sa i përket të drejtës materiale të refuzohen si të pa bazuara dhe që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4656/2022, me datë 19.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj

¹ Shih Mendimi Juridik i Gjyktës Supreme GJ.A.Su.A 214/2023, i datës 05.10.2023.